



LIGJ

Nr. 10 238, datë 18.2.2010

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9616, DATË 27.9.2006 "PËR LIBRIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 10, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Përgjegjësi i Departamentit të Letërsisë në Universitetin e Tiranës."

Neni 2

Në nenin 15, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Mbështetjes me literaturë për grupe të veçanta të shoqërisë, si fëmijët, minoritetet e personat me aftësi të kufizuar, duke financuar nga Fondi Kombëtar i Librit botime të posaçme për ta, përmirësimin të infrastrukturës në institucionet kulturore dhe krijimit të aksesit në informacion."

Neni 3

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 19

1. Pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve krijohet regjistri i botuesve, ku regjistrohen të gjithë botuesit e licencuar për ushtrimin e veprimtarisë botuese në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, të cilët ushtrojnë veprimtari botuese të licencuar në Republikën e Shqipërisë, njoftojnë Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe

Sporteve, brenda një periudhe 3-mujore nga data e fillimit të veprimtarisë, për regjistrimin e të dhënave kryesore, që lidhen me subjektin e tyre.

3. Të dhënat, që duhet të njoftohen për regjistrim nga subjekti, janë:

a) emri i personit fizik ose juridik, që kryen veprimtarinë botuese;

b) numri dhe data e regjistrimit të subjektit botues në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

c) adresa e selisë së subjektit botues;

ç) emri i administratorit ose përfaqësuesit të autorizuar dhe adresa përkatëse;

d) një kopje e logos (markës tregtare) së identifikimit të subjektit botues, e cila vendoset në botimet e subjektit botues.

4. Botuesit, të cilët e ushtrojnë këtë veprimtari përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të regjistrohen në regjistrin e botuesve brenda një afati tremujor nga data e hyrjes në fuqi të ligjit."

Neni 4

Neni 20 shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 21, shkronja "g" shfuqizohet.

Neni 6

Neni 22 shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 41 togfjalëshi "dhe në bibliotekat publike" shfuqizohet.

Neni 8

Neni 44 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 44

Për çdo botim apo ribotim, sipas përcaktimeve të nenit 26, përsëritet e njëjta procedurë e përcaktuar në nenin 43, duke shënuar në të dhënat e botimit apo ribotimit datën e parë, datën e dytë, të tretë e çdo datë pasardhëse në vijim të afatit të dorëzimit."

Neni 9

Në nenin 48 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjat "ç", "d" e "dh" masa e gjobës "nga 100 deri në 1 000-fishin" zëvendësohet me "nga 5 000 (pesë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë".

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhen sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative. Kundërvajtësi duhet ta paguajë gjobën brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për lënien në fuqi të vendimit të gjobës. Në rast mospagimi të gjobës brenda afatit të mësipërm, vendimi për lënien në fuqi të gjobës përbën titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tij ngarkohet zyra e përmbarimit."

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6459, datë 9.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**